Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 13 maj 2011

Lënda nr. 20/08

Kabash Krasniqi

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 13 maj 2011, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
znj. Anila PREMTI, ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive

Pasi që konsideruan ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, konstaton gjetjet dhe rekomandimet vijuese:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 3 korrik 2008 dhe është regjistruar më 4 korrik 2008. Në procedurat para Panelit, ankuesi është përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Më 11 dhe 17 korrik 2008, si dhe më 20 gusht 2008, ankuesi ia parashtroi Panelit disa dokumente shtesë.

3. Paneli ia komunikoi ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 23 tetor 2008, me qëllim të marrjes së komenteve të UNMIK-ut për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës.

4. PSSP-ja ka dhënë komentet e veta më 25 nëntor 2008 lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës.

5. Më 14 prill 2009, lidhur me rastin e ankuesit, Paneli morri kopjet e disa dokumenteve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme).

6. Më 23 prill 2009, Paneli ia rikomunikoi ankesën PSSP-së, së bashku me dokumentet e marra nga Dhoma e Posaçme.

7. Më 14 maj 2009, PSSP-ja parashtroi komente shtesë për rastin.

8. Përmes vendimit të datës 12 shtator 2009, Paneli shpalli ankesën si të pranueshme për pjesën që ka të bëjë me përbërjen e Dhomës së Posaçme, dhe të papranueshme për pjesën e mbetur të ankesës.

9. Më 8 tetor 2009, PSSP-ja parashtroi komentet e tij lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

10. Komentet e PSSP-së i janë komunikuar ankuesit më 2 mars 2011. Ankuesi është ftuar t'i parashtrojë komentet e veta, po qe se dëshironte. Ankuesi dërgoi komentet më 1 prill 2011.

II. FAKTET

11. Ankuesi është shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe jeton në Sarajevë.

12. Faktet relevante për pjesën e ankesës që është shpallur e pranueshme mund të përmblidhen si në vijim.

13. Ankesa ka të bëjë me kontestin lidhur me të drejtën pronësore për dy parcela të tokës, ku njëra gjendet në Prishtinë, ndërsa tjetra në Pejë. Fillimisht këto parcela kanë qenë në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore (NSh) Shipad-Komerc, ndërmarrje kjo me seli në Sarajevë dhe me degë në mbarë territorin e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë edhe Kosovën. Pas pavarësimit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe miratimit pasues të legjislacionit në atë vend lidhur me transformimin e pronës shoqërore në pronë shtetërore dhe me privatizimin ndërmarrjeve, Shipad-Komerc është transformuar në vitin 2001 në kompani private, të quajtur "Shipad-Komerc JSC Sarajevo".

14. Kompania e re ia ka shitur ankuesit dy pronat në fjalë, përmes kontratave të nënshkruara më 31 korrik 2001 dhe të vërtetuara nga Gjykata Komunale e Sarajevës në të njëjtin vit.

15. Kur ankuesi në vitin 2003 tentoi të regjistrojë pronën në emër të vet në Kosovë, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) pati vërejtje në kërkesat e ankuesit

përmes letrave të datës 29 tetor 2003, dërguar Zyrës kadastrale në Prishtinë dhe asaj në Pejë. Në bazë të AKM-së, këto prona ishin ende në pronësi të Shipad-Komerc, ndërmarrje shoqërore kjo që kishte degët e saj në Kosovë. Rrjedhimisht, AKM-ja argumentonte se pronat ishin në administrimin e saj dhe se nuk mund të shiteshin.

16. Më 14 qershor 2005, ankuesi parashtroi ankesë tek Dhoma e Posaçme, përmes së cilës kërkonte nga Dhoma e Posaçme t'i urdhërojë AKM-së të heqë çfarëdo ndalese apo kufizimi për bartjen e pronës tek ai, si dhe t'i urdhërojë zyrat kompetente kadastrale që t'i regjistrojnë pronat në emër të tij. Ankuesi gjithashtu ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të nxjerrë një ndalesë gjyqësore kundër AKM-së me qëllim të përjashtimit të pronave në fjalë nga procesi i privatizimit të NSh-ve.

17. Përmes vendimit të datës 8 qershor 2006, Dhoma e Posaçme refuzoi ankesën e AKM-së në bazë të asaj se kërkesa ka qenë e parashkruar. Vendimi është marrë në përbërje të plotë të Dhomës së Posaçme.

18. Përmes aktgjykimit të datës 5 shkurt 2008, Dhoma e Posaçme nxori vendimin e vet për bazueshmërinë e kërkesës pronësore. Dhoma e Posaçme konstatoi se dy pronat në fjalë ishin nën administrim të AKM-së në datën e kontratës së blerjes dhe se rrjedhimisht nuk kanë qenë lirshëm të transferueshme. Pasi që ankuesi nuk dëshmoi se kishte fletë poseduese të vlefshme për dy pronat, kërkesa pronësore e tij është shpallur si e pabazë. Ky aktgjykim është nxjerrë nga paneli i përbërë prej pesë gjyqtarëve.

19. Më 7 prill 2008, ankuesi parashtroi kërkesë për shqyrtim dhe një ankesë kundër vendimit të datës 5 shkurt 2008.

20. Përmes vendimit të datës 22 prill 2008. Dhoma e Posaçme refuzoi kërkesën e ankuesit për shqyrtim në bazë të asaj se paditësi nuk ka paraqitur ndonjë fakt të ri vendimtar dhe relevant. Ky vendim është nxjerrë nga Dhoma në përbërje të plotë prej pesë gjyqtarëve.

21. Përmes vendimit të veçantë të së njëjtës datë, Dhoma e Posaçme e shpalli ankesën të papranueshme në bazë të asaj se dispozitat, përmes të cilave parashihej mundësia për ankesë, ende nuk kishte hyrë në fuqi. Po ashtu, ky vendim është nxjerrë nga Dhoma në përbërje të plotë.

III. THE COMPLAINT

22. Për pjesën ku ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesi argumenton se Dhoma e Posaçme nuk ka qenë tribunal i "përcaktuar me ligj", në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj). Ai ankohet për faktin se aktgjykimi i datës 5 shkurt 2008 është nxjerrë nga paneli i katër gjyqtarëve, ndërsa legjislatura përkatëse parasheh se paneli duhet të përbëhet prej pesë gjyqtarëve.

IV. LIGJI

A. Fushëveprimi i lëndës para Panelit

23. Në parashtresat e tij për bazueshmëri, ankuesi jep argumente të tjera për qëndrimin e tij se Dhoma e Posaçme ka shkelur të drejtat e tij të ndryshme themelore, duke përfshirë të drejtën pronësore dhe të drejtën në mjet të efektshëm juridik.

24. Në vendimin e tij të datës 12 shtator 2009, Paneli shpalli të pranueshme vetëm ankesën "lidhur me përbërjen e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme". Fushëveprimi i rastit lidhur me bazueshmëri është i përkufizuar përmes vendimit të Panelit për pranueshmëri. Rrjedhimisht, Paneli nuk mund të shqyrtojë ankesa ët ndryshme përkitazi me procedurën para Dhomës së Posaçme apo me thelbin e vendimit të Dhomës së Posaçme (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), *Todorović*, nr. 33/08, Mendimi i datës 15 prill 2011, § 22).

B. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut

Argumentet e palëve

25. Ankuesi pretendon se vendimi për padinë e tij është nxjerrë nga paneli i katër gjyqtarëve, dhe se paneli rrjedhimisht nuk ka qenë i përbërë në përputhje me ligjin. Edhe pse ankuesi i referohet Udhëzimit administrativ nr. 2006/17, të datës 6 dhjetor 2006 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2003/13 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duket se ankesa e tij në realitet është e bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13, të datës 13 qershor 2002 për themelimin Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 parasheh që "Dhoma e Posaçme përbehet prej panelit të pesë gjyqtarëve […]".

26. PSSP-ja argumenton se neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 parasheh numrin e gjyqtarëve që "do të punojnë në Dhomën e Posaçme", dhe se nuk përcakton përbërjen e panelit gjatë mbajtjes së seancave, shqyrtimit dhe gjatë marrjes së vendimit për paditë e ngritura në Dhomën e Posaçme. PSSP-ja më tej i referohet nenit 13.3 të Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2006/17, i cili parasheh se "kryetari i trupit gjykues mund t'ia caktojë shqyrtimin e padive dhe ankesave paneleve të përbëra prej tre gjyqtarëve". Dispozita e fundit rregullon përbërjen e paneleve për seanca dëgjimore, shqyrtim dhe marrjen e vendimit për padi. Fjala "mund" tregon se nuk është e obligueshme që kryetari i trupit gjykues të caktojë panelin e përbërë prej vetëm tre gjyqtarëve. Neni 13.3 në fakt parasheh minimumin e numrit të gjyqtarëve, dhe nuk përjashton që paneli të mund të përbehet prej katër gjyqtarëve, siç është rasti i ankuesit.

Vlerësimi i Panelit

27. Neni 6 § 1 i KEDNJ-së në pjesën e tij relevante parasheh:

> "Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve qytetare...çdokush ka të drejtë në seancë gjyqësore të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm, i themeluar sipas ligjit […]."

28. Siç ka konstatuar Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, kushti që tribunali gjithmonë duhet të jetë i "themeluar me ligj" pasqyron parimin e sundimit të ligjit. Formulimi "i themeluar sipas ligjit" mbulon jo vetëm bazën ligjore për vet ekzistimin e "tribunalit", por edhe, në mes të tjerash, përbërjen e panelit për çdo rast (shih GjEDNj, *Buscarini kundër San Marinos*, nr. 31657/96, vendim i datës 4 maj 2000; GjEDNj, *Lavents kundër Letonisë*, nr. 58442/00, aktgjykim i datës 28 nëntor 2002, § 114).

29. Mosrespektimi nga tribunali i dispozitave të rregullave të organizmit të tij, zakonisht rezulton me shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane lidhur me këtë çështje, Paneli konsideron se ka juridiksion për marrjen e vendimit lidhur me respektimin e rregullave relevante. Megjithatë, në përputhje me parimin e përgjithshëm se gjykatat e Kosovës janë përgjegjëse për interpretimin e ligjit relevant të aplikueshëm në Kosovë, Paneli mendon se duhet të kundërshtojë vlerësimin e gjykatave vetëm në rastet kur ka pasur shkelje flagrante të legjislacionit (shih GjEDNj, *Lavents*, cituar më lartë).

30. Duke iu kthyer rastit në fjalë, Paneli konstaton se në momentin kur Dhoma e Posaçme dorëzoi aktgjykimin e saj, të datës 5 shkurt 2008, organizmi i saj ka qenë objekt i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, të datës 13 qershor 2002. Neni 3.1 parasheh që Dhoma e Posaçme është "e përbërë prej pesë gjyqtarëve, nga të cilët tre janë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy do të jenë gjyqtarë që janë banor të Kosovës". Neni 9.2 parashihte që "vendimet e Dhomës së Posaçme në rastet kur vendimi merret në bazë të nenit 4.1 […] kanë nevojë për votën e së paku tre (3) gjyqtarëve".

31. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 nuk ka paraparë mundësinë e caktimit të paneleve me më pak se pesë gjyqtarë, përveç për grumbullimin e dëshmive apo për seancat dëgjimore. Lidhur me aktivitetet e tilla procedurale, neni 8.2 parasheh që "Dhoma e Posaçme mund të delegojë grumbullimin e dëshmive dhe/apo të mbajtjen e seancave panelit që do të përbëhej prej jo më pak se dy anëtarëve të saj, njëri prej të cilëve është gjyqtar ndërkombëtar. Për rastet kur shuma e kontestuar nuk kalon dhjetë mijë euro (10000 €), Dhoma e Posaçme mund ta delegojë vetëm një gjykatës". Vendimi për padinë qartazi nuk është paraparë në klauzolën e delegimit të nenit 8.2.

32. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 është plotësuar përmes akteve nënligjore. Në pajtim me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, është kompetencë e PSSP-së që të "shpall rregullat për zbatimin e procedurës para Dhomës së Posaçme përmes lëshimit të Urdhëresës administrative". Në momentin kur Dhoma e Posaçme ka dorëzuar aktgjykimin e saj për rastin e ankuesit, këto rregulla parashiheshin në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/17, të datës 17 dhjetor 2006 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës administrative nr. 2006/17 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës administrative nr. 2003/13 për

zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Siç cek PSSP-ja me të drejtë, neni 13.3 i kësaj Urdhërese administrative, ka paraparë që "kryetari i trupit gjykues mund t'ia caktojë shqyrtimin e padive dhe ankesave paneleve të përbëra prej tre gjyqtarëve". E njëjta dispozitë thoshte se "të gjitha aktgjykimet apo vendimet të këtyre paneleve miratohen me konsensus, dhe nëse i njëjti nuk arrihet, çështja do t'i dërgohej Panelit Dhomës së Posaçme në përbërje të plotë". Duke theksuar nenin 9.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, neni 16.4 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17 parashihte që "të gjitha aktgjykimet dhe vendimet vendosen përmes votës në favor të së paku tre gjyqtarëve".

33. Derisa Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 nuk ka paraparë panele për marrjen e vendimeve, të përbëra nga më pak se pesë gjyqtarë, Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2006/17 ka paraparë një gjë të tillë. Rrjedhimisht, pyetja e parë që parashtrohet është nëse Urdhëresa administrative, duke lejuar krijimin e paneleve prej më pak se pesë gjyqtarëve, është në përputhje me Rregulloren. Nëse përgjigja është pozitive, pyetja tjetër që shtohet është nëse parashihen panelet e përbëra prej katër gjyqtarëve, siç ishte rasti te ankuesi.

34. Në shikim të parë, teksti i nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mund të duket i qartë. Aty duket se parashihet një panel i vetëm në kuadër të Dhomës së Posaçme, i përbërë prej pesë gjyqtarëve. Numri i pesë gjyqtarëve do të mund të interpretohej si numër i gjyqtarëve që do të shqyrtonin secilin rast. Rregulla e shumicës, e paraparë në nenin 9.2 sipas këtij interpretimi thjesht do t'i referohej shumicës absolute në kuadër të panelit të pesë gjyqtarëve.

35. Megjithatë, ka elemente që çojnë në drejtim të interpretimit tjetër. Pasi që Dhoma e Posaçme është një entitet i veçantë brenda Gjykatës Supreme, kuptohet se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 përcakton numrin e gjyqtarëve të Dhomës së Veçantë në kuptim të përbërjes së "panelit". Fjala "panel" në fakt mund të kuptohet se i referohet panelit të veçantë brenda Gjykatës Supreme dhe, rrjedhimisht, përbërjes së Dhomës së Posaçme si të tillë. Për më tepër, dispozita ku thuhet se kërkohet "vota në favor" e së paku tre gjyqtarëve për miratimin e aktgjykimit në fakt nuk i shton asgjë rregullës së zbatueshme në përgjithësi, nëse Dhoma e Posaçme gjithmonë do të duhej t'i mbajë shqyrtimet me pesë gjyqtarë. Nga ana tjetër, rregulla e shumicës prej "tre gjyqtarëve" merr domethënie të veçantë, nëse kuptohet se Dhoma e Posaçme po ashtu mund të mbajë seanca me më pak se pesë gjyqtarë për ndonjë rast. Sipas interpretimit që rregulla parasheh numrin absolut minimal të gjyqtarëve të nevojshëm për miratimin e çfarëdo vendimi për rastin në fjalë, pavarësisht numrit të gjyqtarëve që merren me rastin.

36. Duke marrë parasysh dykuptimësinë e formulimit të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, Paneli konsideron se rëndësi e posaçme duhet t'i kushtohet mënyrës se si është interpretuar kjo dispozitë nga autoritetet kompetente për zbatimin e tyre. Pikësëpari vet PSSP-ja nuk ka parë pengesë në nenin 3.1 me rastin e miratimit të "rregullave për zbatimin e procedurës" në formë të udhëzimit administrativ, ku parashiheshin panelet brenda Dhomës së Posaçme, të përbërë prej më pak se pesë gjyqtarë. Për më tepër, rasti në fjalë tregon se Dhoma e

Posaçme po ashtu konsideron se rasti mund të shqyrtohet nga paneli i përbërë prej më pak anëtarëve se numri i plotë i paraparë i anëtarëve të Dhomës së Posaçme. Interpretimi i nenit 3.1 nga Dhoma e Posaçme është i një rëndësie të posaçme, pasi që, siç është cekur më lartë, interpretimi i ligjit është rol saktësisht i Dhomës së Posaçme.

37. Dhe në fund, duhet të merren parasysh aspektet praktike të funksionimit të organit gjyqësor, veçanërisht në rastet kur përbëhet pjesërisht prej gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe pjesërisht prej atyre vendorë. Kërkesa që një organ i tillë gjithmonë të bëjë shqyrtimet në përbërje të plotë do të çonte në situata ku organi, p.sh. për shkak të vendit të lirë apo mungesës së përkohshme të një apo më shumë anëtarëve, në fakt nuk do të jetë në gjendje të kryej funksionet e tij gjyqësore për një periudhë kohore më të gjatë apo më të shkurtër.

38. Duke konsideruar atë që u cek më lartë, paneli vjen në përfudnim se neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 duhet të interpretohet në atë mënyrë që t'i referohet përbërjes së Dhomës së Posaçme si tërësi, e jo përbërjes së paneleve që mund të krijohen për shqyrtimin e rasteve veç e veç. Sipas kësaj, nenin 13.3 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17, ku parashihet caktimi i paneleve prej tre gjyqtarëve për shqyrtim të padive, pra, të paneleve prej më pak se pesë gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme, nuk është në mospërputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13.

39. Mbetet të shihet nëse, pavarësisht formulimit të nenit 13.3 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17, paneli i Dhomës së Posaçme mund të përbëhet prej katër, jo tre e as prej pesë gjyqtarëve.

40. Paneli mendon se, për dallim prej nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13, neni 13.3 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17 nuk le hapësirë për ndonjë dykuptimësi. Fjalia e parë e nenit 13.3 parasheh "panelet e përbëra prej tre gjyqtarëve" e jo prej së paku tre gjyqtarëve. Ky interpretim strikt mbështetet nga fakti se fjalia e dytë vazhdon duke saktësuar se "një panel i tillë prej tre gjyqtarëve" përbëhet prej kryetarit të trupit gjykues të Dhomës së Posaçme apo prej një të deleguari të tij, prej një gjyqtari ndërkombëtar dhe prej një gjyqtari që është banor i Kosovës. Asgjë nuk parashihet për përbërjen e panelit prej katër gjyqtarëve.

41. Përfundimi është se rasti para Dhomës së Posaçme do të mund të shqyrtohej qoftë nga Dhoma e Posaçme në përbërje të plotë prej pesë gjyqtarëve apo nga paneli prej tre gjyqtarëve, duke pasqyruar përbërjen e përzier të Dhomës së Posaçme (shumica gjyqtarë ndërkombëtarë dhe pakica gjyqtarë vendorë), por jo edhe nga paneli prej katër gjyqtarëve. Nëse lënda do t'i jepej panelit prej tre gjyqtarëve, vendimet do të duhet të miratoheshin unanimisht; nëse një gjyqtar nuk do të mund t'i bashkohej dy kolegëve të tij, lënda do të duhet t'i referohej panelit në përbërje të plotë të Dhomës së Posaçme prej pesë anëtarësh.

42. Mund të ketë pasur situata kur, siç është cekur më lartë, paneli në përbërje të plotë i Dhomës së Posaçme nuk ka pasur mundësi të bëjë shqyrtime me pesë gjyqtarë (shih § 37). Do të ishte plotësisht e kuptueshme nëse korniza rregullative në fuqi do t'ia mundësonte kryetarit të trupit gjykues që në rrethana të caktuara të mos

zbatojë rregullat e përgjithshme në fuqi dhe t'ia caktojë lëndët e caktuara panelit prej katër gjyqtarëve. Mirëpo, nuk kishte asgjë në atë kornizë që shprehimisht do t'ia mundësonte kryetarit të trupit gjykues një gjë të tillë. Edhe nëse supozojmë se kryetari i trupit gjykues në mënyrë të nënkuptuar ka pasur kompetencë të gjej zgjidhje të atypëratyshme në rast të nevojës, në ligj nuk janë paraparë kurrfarë kriteresh në këtë drejtim. Pasiguria juridike që rezulton dhe mungesa e transparencës në vetvete nuk janë në përputhje me kushtin që tribunali duhet të themelohet "sipas ligjit", pra, që përbërja e tij duhet të përcaktohet në bazë të rregullave të qarta, në mënyrë që të shmanget çfarëdo arbitrariteti në caktimin e lëndëve gjyqtarëve (shih GjEDNj, *Iwańczuk kundër Polonisë*, nr. 39279/05, vendimi i datës 17 nëntor 2009; GjEDNj, *DMD Group A.S. kundër Sllovakisë*, nr. 19334/03, aktgjykim i datës 5 tetor 2010, § 66).

43. Rrjedhimisht, Dhoma e Posaçme, gjatë shqyrtimit të lëndës së ankuesit me katër gjyqtarë nuk mund të konsiderohet si tribunal "themeluar sipas ligjit".

44. Ankesa pasuese dhe kërkesa për shqyrtim nuk kanë pasur mundësinë e korrigjimit të kësaj parregullsie, edhe pse që të dyja janë shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme në përbërje të plotë prej pesë gjyqtarëve. Ankesa është shpallur e papranueshme, ndërsa kërkesa për shqyrtim është refuzuar në bazë të asaj se ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt të ri vendimtar që do të mund të ndikonte në vendimin e datës 5 shkurt 2008.

45. Rrjedhimisht Paneli vjen në përfundim se neni 6 § 1 i KEDNj-së është shkelur.

V. REKOMANDIMET

46. Duke pasur parasysh natyrën e shkeljes së nenit 6 § 1 të KEDNj-së, Paneli nuk mund të spekulojë nëse rezultati i procedurave do të ishte tjetër po qe se nuk do të ndodhte kjo shkelje. Prandaj, nuk rekomandon ndonjë kompensim për dëme materiale.

47. Sido që të jetë, mbetet fakti se procedura lidhur me kërkesën e ankuesit për rishqyrtim, sipas mendimit të Panelit nuk është zbatuar plotësisht në përputhje me KEDNj-në.

48. Paneli konsideron se pranimi i shkeljes nga ana e UNMIK-ut do të paraqiste formë të duhur të zgjidhjes së çfarëdo dëmi jomaterial që ankuesi mund të ketë përjetuar.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;

2. REKOMANDON QË PËRFAQËSUESI SPECIAL I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË EMËR TË UNMIK-UT TË PRANOJ SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT.

Anila PREMTI	Marek NOWICKI
Ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive	Kryesues